



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO  
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS  
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



## UDHËZIM ADMINISTRATIV

Nr. 02/2005, Data .02.2005

**PER ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2004/52**

### **‘MBI TATIMIN NË TË ARDHURA PERSONALE’**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me nenet e ndryshme të Rregullores së UNMIK Nr. 2004/52 “Mbi Tatimin në të Ardhura Personale”, nxjerr Udhëzimin Administrativ vijues lidhur me zbatimin e Rregullores:

#### Neni 1 Përkufizimet

Për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ:

‘*Veprimtari biznesi*’ nënkupton çdo veprimtari ekonomike, siç është definuar në Nenin 1 të Rregullores, e filluar për qëllim të përfitimit, çfarëdo qoftë rezultati i veprimtarisë. Zakonisht, veprimtaria me qëllim fitimi ose me qëllim jofitimi është cekur në statusin dhe aktin e themelimit të entitetit dhe në formularin e aplikimit për regjistrim të ndërmarrjeve biznese personale dhe individëve të vetëpunësuar. Nëse një organizatë biznesi e cila është themeluar me qëllim fitimi realizon humbje, ajo ende mbetet e përfshirë në veprimtari ekonomike. Nëse një organizatë me qëllim jofitimi e cila është themeluar për përfitim publik realizon fitim i cili prapë është përdorur që t’i shërbejë përfitimit publik, kjo domosdoshmërisht nuk nënkupton se është përfshirë në veprimtari ekonomike.

“I punësuar” nënkupton një person fizik, siç është definuar në Nenin 1 të Rregullores. Një person fizik i cili nuk quhet i punësuar, por diçka tjetër, sikurse është ‘drejtor’, ‘zyrtar’, parlamentar’, ‘ministër’, ‘nëpunës’ etj., do të gjykohet të jetë i punësuar nëse së paku dy prej katër testeve vijuese janë plotësuar:

- Si një rregull i përgjithshëm një i punësuar nuk është në rrezik për të marrë pagesën,
- Si një rregull i përgjithshëm një i punësuar nuk kërkohet të investojë në instrumente, vegla dhe pajisjet pune,
- Si një rregull i përgjithshëm një i punësuar nuk e cakton vendin dhe kohën e punës,
- Si një rregull i përgjithshëm një i punësuar nuk punon për më tepër se një punëdhënës.

'Punëdhënësi kryesor' është definuar në Nenin 1 të Rregullores. Ky nen poashtu parasheh që secili i punësuar të caktojë Punëdhënësin Kryesor të tij/saj. Secili i punësuar, pavaresisht nëse punon për një apo më tepër punëdhënës, do të caktojë një Punëdhënës Kryesor. Të punësuarit të cilët tashmë kanë caktuar Punëdhënësin Kryesor të vetin sipas kërkesave të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2002/4 dhe të cilët nuk dëshirojnë të ndërrojnë Punëdhënësin Kryesor të vetin, nuk kërkohet të ndërmarrin ndonjë veprim shtesë të caktimit. Të punësuarit të cilët fillojnë marrëdhëniet e punës më ose pas 1 Janarit 2005 do të caktojnë një Punëdhënës Kryesor mbrenda 15 ditëve nga fillimi i datës së punësimit duke plotësuar dhe dorëzuar Formularin e Caktimit të Punëdhënësit Kryesor në Administratën Tatimore të Kosovës. Një i punësuar i cili ndërton Punëdhënësin Kryesor do të caktojë një Punëdhënës Kryesor të ri mbrenda 15 ditëve nga ndërrimi duke plotësuar dhe dorëzuar Formularin e Caktimit të Punëdhënësit Kryesor të ri në Administratën Tatimore të Kosovës. Format i Formularit të Caktimit të Punëdhënësit Kryesor është me sa vijon:

<b>Formular i Caktimit të Punëdhënësit Kryesor</b>			
[1] Emri i të Punësuarit	<input type="text" value="111"/>	[2] Numri Serik	<input type="text" value="121"/>
[3] NP-UNMIK/Numri Individual i Tatimpaguesit(*)	<input type="text" value="131"/>		
[4] Adresa e të punësuarit	<input type="text" value="141"/>		[5] Telefoni
[6] Pozita/Titulli	<input type="text" value="161"/>	<input type="text" value="151"/>	
[7] Data e fillimit të punësimit	<input type="text" value="171"/>		
<b>Unë, i nënshkruari, më anë të kësaj caktoj punëdhënësin e mëposhtëm si punëdhënësin tim kryesor.</b>			
[8] Emri i punëdhënësit	<input type="text" value="181"/>		
[9] Numri i Rregjistrimit të Punëdhënësit	<input type="text" value="191"/>		
<small>[Vendos Numrin e Rregjistrimit të Biznesit, Numrin e Rregjistrimit të OJQ-së ose Numrin e Rregjistrimit të Punëdhënësit të lëshuar nga Administrata Tatimore]</small>			
[10] Pronari/Menaxheri	<input type="text" value="1101"/>	[11] Tel.	<input type="text" value="1111"/>
[12] Adresa e punëdhënësit	<input type="text" value="1121"/>	[13] Tel.	<input type="text" value="1131"/>
<b>(*) Nëse i punësuarit nuk ka Numër Personal të UNMIK-ut, ai/ajo duhet të aplikojë në Administratën Tatimore që të pajiset me një Numër Individual të Tatimpaguesit.</b>			
Emri dhe nënshkrimi i të punësuarit		dd/mm/vv	
(_____)		____/____/____	

'Rregullore' nënkupton Rregulloren e UNMIK-ut 2004/52 "Mbi Tatimin në të Ardhura Personale".

'Rezident' është definuar në nenin 1 të Rregullores.

Sa i përket individëve:

- kërkesa e 183 ditëve nënkupton numrin total të ditëve e të qënurit fizikisht i pranishëm në Kosovë, me apo pa ndërprerje. Nëse një pjesë e ditës është kaluar në Kosovë do të llogaritet si një ditë e plotë e kaluar në Kosovë.

- Termi 'rezidencë kryesore' e individit nënkupton vendin ku jeton familja e individit, aty ku interesat kryesore jetësore të individit janë të lidhura dhe të tjera si këto. Poashtu në definimin e rezidencës kryesore shuma e kohës së kaluar dhe natyra e kohës së kaluar do të merren parasysh.

Sa i përket entiteteve:

- kërkesa e të 'qenurit i themeluar' në Kosovë nënkupton se entiteti qoftë një organizatë biznesi ose organizatë jofitimprurëse ose një trup qeveritar etj., është themeluar sipas ligjit të Kosovës dhe është i regjistruar tek autoritetet kompetente përkatëse në Kosovë.

- Termi 'vendi i menaxhmentit efektiv' nënkupton vendin ku pjesa më e madhe e drejtorave ekzekutiv qëndrojnë dhe drejtojnë punën e opeacioneve të përditshme. Nuk nënkupton domosdoshmërisht zyrat qendrore të entitetit.

## Neni 2

### Objekt i tatuarjes

Neni 3 i Rregullores definon objektin e tatuarjes. Për një individ jorezident vetëm pjesa e të ardhurave të tatueshme që rrjedhin nga një burim i Kosovës do të jetë objekt i tatuarjes. P.sh. një ekspert italian i kompjuterave rri në Kosovë për 100 ditë dhe realizon të ardhura nga pagat nga një kontratë punësimi që ai e ka me një organizatë biznesi të Kosovës. Paga e tij është e tatueshme në Kosovë dhe ai mund të kërkojë kreditimin tatimor të huaj në Itali. Për një resident në Kosovë objekti i tatuarjes do të përfshijë të ardhurat që rrjedhin nga burimet e Kosovës si dhe të ardhurat që burojnë nga jashtë Kosovës, p.sh. një ligjërues kosovar realizon të ardhura nga pagat në Universitetin e Prishtinës dhe poashtu ai realizon të ardhura nga ligjëratat e dhëna në Universitetin e Tetovës, Maqedoni. Për të ardhurat e realizuara në Maqedoni ai do t'i paguajë tatime Maqedonisë dhe të kërkojë kreditim tatimor të huaj kur të dorëzojë deklaratën tatimore vjetore në Kosovë në të cilën do të përfshihen edhe të ardhurat e realizuara në Maqedoni.

## Neni 3

### Shkallët tatimore

Neni 5 i Rregullores imponon shkallët tatimore. Shkallët tatimore janë progresive mbi grupet e të ardhurave. P.sh. në rast të një individi i cili ka të ardhura tatimore vjetore prej 6,400 euro, shkallët tatimore aplikohen me sa vijon:

<b>Te Ardhurat e Tatueshme</b>	<b>Shkalla tatimore</b>	<b>Tatimi</b>
Të ardhurat e tatueshme 0-960 euro	0%	0 euro
Të ardhurat e tatueshme 960.01-3,000 euro	5%	102 euro
Të ardhurat e tatueshme 3,000.01-5,400 euro	10%	240 euro
Të ardhurat e tatueshme 5,400.01-6,400 euro	20%	200 euro
	Totali:	542 euro

#### Neni 4

##### Të ardhurat bruto

Neni 6 i Rregullores i referohet të Ardhurave Bruto si te ardhura të realizuara apo të akruara nga të gjitha burimet. Për të ardhurat bruto vijuese, shprehja *'të realizuara apo të akruara'* do të ketë kuptimin vijues:

1. *Pagat.* Zakonisht pagat paguhen një herë, dy herë ose edhe më tepër në muaj edhe pse shërbimet e punësimit jepen çdo ditë. 'Të realizuara' nënkupton se i punësuari ka marrë kompensimin për shërbimet e dhëna gjatë muajit, qoftë në para të gatshme apo forma tjera të pagesës. 'Akruara' nënkupton se nuk është marrë kompensim në shkëmbim të shërbimeve të dhëna gjatë periudhës së punës. Për qëllime të këtij Udhezimi Administrativ te ardhurat nga pagat do te perfshihen ne te ardhurat bruto te periudhes tatimore ne te cilen paga paguhet nga punedhenesi dhe merret nga i punesuari, dhe shpenzimi i pagave per punedhenesin do te zbritet ne te njejten periudhe tatimore.
2. *Veprimtaritë e biznesit.* 'Të realizuara' nënkupton se të ardhurat janë marrë në periudhën tatimore kur mallrat janë furnizuar ose shërbimet janë dhënë. Për ndërmarrjet biznesore personale dhe individët e vetëpunësuar që janë subjekt i tatuarjes së paragjykuar, metoda e kontabilitetit do të jetë ajo e parave të gatshme (cash) ashtu që të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore kur janë marrë paratë. Për ndërmarrjet biznesore personale dhe individët e vetëpunësuar që janë subjekt i tatuarjes së të ardhurave reale metoda e kontabilitetit do të jetë ajo akruale ashtu që të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore kur mallrat janë furnizuar dhe shërbimet janë dhënë, fatura është lëshuar apo paratë janë marrë, cilado që ndodh e para.
3. *Qiratë.* 'Të realizuara' nënkupton se të ardhurat nga qiraja janë marrë në periudhën tatimore aty ku pasuria e paluajtshme apo e luajtshme është dhënë me qira. Për ndërmarrjet biznesore personale, individët e vetëpunësuar dhe individët e tjerë që nuk janë të përfshirë në veprimtari biznesi të cilët janë subjekt i tatuarjes së paragjykuar, metoda e kontabilitetit do të jetë ajo e parave të gatshme ashtu që të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore kur janë marrë paratë. Për ndërmarrjet biznesore personale, individët e vetëpunësuar dhe individët tjerë që nuk janë të përfshirë në veprimtari biznesi të cilët janë subjekt i tatuarjes së të ardhurave reale metoda e kontabilitetit do të jetë ajo akruale. 'Të akruara' për këtë kategori nënkupton se të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën paratë janë marrë, është lëshuar fatura apo shërbimet e qirasë janë dhënë, cilado që ndodh e para.

4. *Shfrytëzimi i pasurisë së patrupëzuar.* ‘Të realizuara’ nënkupton që të ardhurat nga patentat, të drejtat e autorit, markat tregtare, franshizat etj., janë marrë në periudhën tatimore kur shfrytëzimi i pasurisë së patrupëzuar ka gjeneruar të ardhurat e tilla. Për ndërmarrjet biznesore personale, individët e vetëpunësuar dhe individët e tjerë që nuk janë të përfshirë në veprimtari biznesi të cilët janë subjekt i tatuarjes së paragjykuar, metoda e kontabilitetit do të jetë ajo e parave të gatshme ashtu që të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore kur janë marrë paratë. Për ndërmarrjet biznesore personale, individët e vetëpunësuar dhe individët tjerë që nuk janë të përfshirë në veprimtari biznesi të cilët janë subjekt i tatuarjes së të ardhurave reale metoda e kontabilitetit do të jetë ajo akruale. ‘Të akruara’ për këtë kategori nënkupton se të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën paratë janë marrë, është lëshuar fatura apo të drejtat e pasurisë së patrupëzuar janë dhuruar, cilado që ndodh e para.
5. *Interesi.* ‘Të realizuara’ nënkupton se interesi është tërhequr dhe kështu të ardhurat nga interesi do të raportohen në periudhën tatimore kur interesi është marrë. ‘I akruar’ nënkupton se interesi është kapitalizuar me principalin e depositës në momentin e maturimit të depozitit ashtu që pa marrë parasysh tërheqjen e interesit, të ardhurat nga interesi do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën maturohet depoziti. Për interesin e paguar apo kredituar pas hyrjes në fuqi të Rregullores tatimi do të mbahet në burim për tërë shumën e interesit dhe jo vetëm në pjesën që korrespondon me numrin e ditëve të depozitit pas 1 Janarit 2005.
6. *Dividentët.* ‘Të realizuara’ nënkupton se dividendi është shpërndarë nga kompania e aksionerit dhe kështu të ardhurat nga dividendi do të raportohen në periudhën tatimore kur dividendi i tillë është marrë. ‘I akruar’ nënkupton se dividendi është kapitalizuar ose është shndërruar në aksione shtesë dhe të ardhurat nga dividendët do të raportohen në atë periudhë tatimore në të cilën distributori i dividendës identifikon se ekziston një dividend për aksionerët.
7. *Fitimi kapital.* ‘Të realizuara’ nënkupton se një fitim nga shitja e pasurisë së paluajtshme ose letrave me vlerë ka rezultuar dhe pagesa është marrë gjatë periudhës tatimore. Për ndërmarrjet biznesore personale, individët e vetëpunësuar dhe individët tjerë që nuk janë të përfshirë në veprimtari biznesi të cilët janë subjekt i tatuarjes së paragjykuar, metoda e kontabilitetit do të jetë ajo e parave të gatshme ashtu që të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore kur janë marrë paratë. Për ndërmarrjet biznesore personale, individët e vetëpunësuar dhe individët tjerë që nuk janë të përfshirë në veprimtari biznesi të cilët janë subjekt i tatuarjes së të ardhurave reale metoda e kontabilitetit do të jetë ajo akruale. ‘Të akruara’ për këtë kategori nënkupton se të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën paratë janë marrë, është lëshuar fatura apo pasuria e patrupëzuar ose letrat me vlerë janë vënë në shitje, cilado që ndodh e para.
8. *Fitoret në lotari dhe bixhoz.* ‘Të realizuara’ dhe ‘të akruara’ do të kenë të njëjtin kuptim për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ. Të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën organizatori ka bërë shpalljen e çmimit fitues pa marrë parasysh faktin se çmimi i tillë është tërhequr apo jo nga fituesi.

9. *Pensionet*. 'I realizuar' nenkupton qe pensioneri e ka terhequr pensionin e tij ndersa 'i akruar' nenkupton qe pensioni nuk eshte terhequr pavaresisht se ka egzistuar e drejta per ta marre ate. Per qellime te ketij Udhhezimi Administrativ, e ardhura nga pensionet do te perfshihet ne te ardhurat bruto te periudhes tatimore ne te cilen pensioni paguhet nga trusti pensional a skema pensionale dhe merret nga pensioneri.

#### Neni 5

##### Të huajt

Neni 7 i Rregullores i referohet '*diplomatëve të huaj*', '*personelit të juaj*', '*përfaqësuesve të huaj*' etj. Termi '*i huaj*' është përdorë për të definuar një individ i cili nuk është një banor resident i Kosovës dhe i cili si rrjedhojë nuk kërkohet të regjistrohet në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës sikurse parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2000/13.

#### Neni 6

##### Përfitimet në natyrë

Neni 8.1(h) i Rregullores parasheh që të Ardhurat Bruto nga Pagat përfshijnë përfitimet në natyrë të dhëna nga punëdhënësi për të punësuarin e që tejkalon një shumë minimale. Për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ, shuma minimale do të jetë prej 50 euro për muaj. Për shembull, nëse një i punësuar merr nga punëdhënësi përfitime në natyrë prej 80 euro/muaj, shuma prej 30 euro, që tejkalon shumën minimale prej 50 euro, do të përfshihet në të Ardhurat Bruto nga Pagat.

#### Neni 7

##### Shpenzimet e udhëtimit për punë

Neni 8.2(a) i Rregullores parasheh që të Ardhurat Bruto nga Pagat nuk do të përfshijnë rimbursimin për shpenzimet aktuale të udhëtimit për punë. Për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ, shpenzimet e udhëtimit për punë përfshijnë transportin, fjetjen dhe shujtat për udhëtime pune por nuk përfshijnë pagesat për shkuarje ardhje në vendin e punës. Kushtet në vijim duhet të plotësohen ashtu që të kualifikohen shpenzimet e udhëtimit për punë si të tilla:

- Udhëtimi për punë duhet të jetë autorizuar me shkrim nga niveli i duhur menaxherial;
- Duhet të ceket qartë qëllimi i udhëtimit për punë;
- Një kërkesë për udhëtim duhet t'i dorëzohet punëdhënësit në përputhje me politikat e pagesave të udhëtimit të punëdhënësit;
- Shuma e rimbursuar për fjetje duhet të jetë mbrenda një limiti të vendosur në dokumentin e politikave të pagesave të udhëtimit të punëdhënësit. Për qëllime tatimore nuk duhet të jetë më e lartë se 40 euro për fjetje mbrenda në Kosovë dhe 80 euro për fjetje jashtë Kosovës;
- Shuma e rimbursuar për transport mbrenda Kosovës duhet të jetë kostoja aktuale e transportit publik ose një shumë e arsyeshme për kilometër e cekur në dokumentin e politikave të pagesave të udhëtimit të punëdhënësit. Për qëllime tatimore nuk duhet të jetë më e lartë se 15

cent/kilometër. Për udhëtime jashtë Kosovës nuk aplikohet limit me kusht që fatura/bileta e transportit është e gatshme për inspektim nga Administra Tatimore e Kosovës.

- Shuma e rimbursuar për shujta duhet të jetë një shumë e specifikuar për mëngjes, drekë ose darkë e cekur në dokumentin e politikave të lejesave të udhëtimit të punëdhënësit. Për qëllime tatimore nuk duhet të jetë më e lartë se 10 euro për ditë udhëtimi dhe 20 euro për udhëtime ku kalohet nata mbrenda në Kosovë dhe për udhëtime jashtë Kosovës nuk duhet të tejkalojë 30 euro për ditë udhëtimi dhe 60 euro për udhëtim ku kalohet nata;
- Shpenzimet e udhëtimit të punës duhet të regjistrohen në tërësi në librat kontabël të punëdhënësit.

## Neni 8

### Shpenzimet e përfaqësimit për veprimtari biznesi

Ne Nenin 9.3(a) të Rregullores, shpenzimet e përfaqësimit janë shpenzimet që lindin për promovim, publicitet, reklamim dhe përfaqësim të prodhimeve dhe biznesit. Shpenzimet e tilla janë të zbritshme deri në një shumë të barabartë me 2% të të ardhurave të përgjithshme bruto vjetore. Shprehja *'të ardhruat bruto totale'* nënkupton të gjitha të ardhurat që kanë lindur gjatë periudhës tatimore nga burime mbrenda në Kosovë dhe përfshinë të ardhura nga veprimtaritë e biznesit, të ardhura nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme, të paluajtshme, të patrupëzuar, të ardhurat nga interesi, të ardhurat nga dividendët, fitimet nga shitja e letrave me vlerë apo pasurisë së paluajtshme dhe çdo të ardhur tjetër që nuk është përfshirë në mënyrë të veçantë më lartë.

## Neni 9

### Borxhet e këqija

Ne Nenin 9.3(b)(iii) 'evidencë adekuate' do të ketë kuptimet vijuese:

- vendimi i final një gjyqi kompetent që çertifikon se borxhi është i pambledhshëm;
- çertifikimin zyrtar e aksionit të pasukseshëm të mbledhjes së detyrueshme;
- çertifikimin e policisë apo agjencioni tjetër që zbaton ligjin që argumenton se borxhliu i tatimpaguesit nuk mund të zbulohet;
- çertifikatën e zyrës civile që argumenton se tatimpaguesi ka vdekur, dhe
- çdo dokument tjetër zyrtar që mbështet krijimin e një dispozite të borxhit të keq.

## Neni 10

### Zbritja e shpenzimeve të udhëtimit të punës për veprimtaritë e biznesit

Neni 9.3 (d) i Rregullores parasheh për zbritjen nga 'të Ardhurat Bruto nga Veprimtaritë e Biznesit' shpenzime të caktuara udhëtimi të punës. Këto do të jenë ato të përshkruara në Nenin 7 të këtij Udhëzimi Administrativ.

## Neni 11

### Stoqet

Neni 9.7 i Rregullores parasheh se metoda e stoqeve e përdorur nga tatimpaguesit të cilët mbajnë rezeerva të mallrave do të jetë LIFO (e fundit mbrenda e para jashte) apo ndonjë metodë tjetër e lejuar. Metodat e lejuara janë poashtu FIFO (e para mbrenda e para jashte) dhe çdo metodë tjetër e lejuar sipas Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës, me kusht që tatimpaguesit të mos ndërrojnë metodën e tyre të stoqeve gjatë periudhës tatimore.

#### Neni 12

##### Dokumentimi i shpenzimeve të zbritshme

Sipas Nenit 9.10 të Rregullores, nuk do të lejohet zbritje përderisa tatimpaguesi nuk dokumenton si duhet shumën e shpenzimeve të kryera. Për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ si dokumente zyrtare për të mbështetur shpenzimet do të njihen me sa vijon:

- faturat komerciale;
- kuponat komercial;
- deklaratat e Doganës;
- dëftesat, biletat, biletat e fluturimit;
- aktet e blerjes,
- çertifikatat e mbatjes, dhe
- çdo dokument tjetër valid që mbështet shpenzimet.

#### Neni 13

##### Zbritjet nga të ardhurat bruto të qirasë

Neni 10.2 i Rregullores parasheh që të jenë dy metoda për të kërkuar zbritjet e lejueshme nga të ardhurat e qirasë bruto:

1. metoda e kostos aktuale, ose
2. 20% zbritje lejohet për të ardhurat nga qiraja

Sa i përket metodës së parë të gjitha shpenzimet e kryera në tërësi dhe në veçanti në gjenerimin e të ardhurave nga qiraja duhet të dokumentohen sic duhet dhe regjistrimet duhet të mbahen në përputhje me kërkesat që aplikohen në verpimtaritë e biznesit. Regjistrimet e tilla përfshijnë faturat, deklaratat, kontratat, marrëveshjet dhe çdo dokument tjetër valid që mund të mbështesë shpenzimet e kryera.

Sa i përket metodës së dytë jepet një zbritje automatike nga të ardhurat bruto të qirasë për të mbuluar koston e riparimeve, mirëmbatjes, inkasimit etj. Në këtë rast nuk kërkohet dokumentacion mbështetës.

#### Neni 14

##### Zbritjet nga të ardhurat bruto nga pasuria e patrupëzuar

Neni 11.2 i Rregullores parasheh që, me qëllim që për një shpenzim të lejohet si zbritje nga 'të ardhurat bruto nga pasuria e patrupëzuar', duhet të dokumentohet si duhet dhe regjistrimet duhet të mbahen në përputhje me kërkesat që aplikohen në verpimtaritë e biznesit. Regjistrimet e tilla përfshijnë faturat, deklaratat, kontratat, marrëveshjet dhe çdo dokument tjetër valid që mund të mbështesë shpenzimet që janë kryer.



## Neni 15

### Fitimi apo humbja kapitale mes personave të lidhur

Neni 14.4 i Rregullores parasheh për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të shpallë akte nënligjore për të definuar metodat për rregullimin e çmimit të transaksionit në mes të personave të lidhur në çmimin e tregut. Meqë aplikimi i këtij neni është shtyrë deri më 1 Janar 2010, metodat e tilla do të dekretohen në një akt nënligjor pasues.

## Neni 16

### Të Ardhura të tjera

‘Te Ardhura te Tjera’ qe ceket ne nenin 15 te Rregullores, perfshinë çdo te ardhur tjetër qe nuk është cituar specifikisht ne nenin 6 te rregullores, si te ardhurat nga cmimet jo ne para te gatshme te llotarive p.sh., autoveturat, faljen e borxheve etj., te cilat e rrisin pasurine neto te tatimpaguesit. Nje e ardhur e tille do te perfshihet ne te ardhurat bruto te periudhes tatimore ne te cilen ajo është perfiturar. Ne rastin e cmimeve te llotarive jo ne para te gatshme tatimpaguesi duhet te vleresoje mallrat e perfiturar bazuar ne vleren e tregut te atyre mallrave.

## Neni 17

### Kontributet bamirëse

Sipas Nenit 16.4 të Rregullores, tatimpaguesit të cilët kërkojnë një zbritje për kontributet bamirëse të bëra gjatë periudhës tatimore do të sigurojnë, kur të dorëzojnë deklaratën vjetore tatimore dhe pasqyrat financiarë përkatëse, një kupon të nënshkruar dhe të vulosur nga përfituesi i kontributit bamirës, që vërteton qëllimin e donacionit, shumën e donacionit dhe kohën kur është bërë donacioni. Nje zbritje per kontributet bamirëse do te lejohet vetem per ata tatimpagues te cilet paguajne tatimin mbi te ardhurat personale bazuar ne ‘te ardhurat reale’ dhe qe u kerkohet te dorezojne nje deklarate vjetore tatimore. Tatimpaguesit qe paguajne ne menyre te ‘paragjykuar’ nuk mund ta perfitojne nje zbritje te tille. Format i kuponit qe duhet paraqitur se bashku me deklaratën vjetore jepet ketu me poshte:

#### **Dëftesa e Kontributeve Bamirëse**

1.Emri i donatorit	[1]
2.Numri ID i donatorit	[2]
3.Adresa e donatorit	[3]
4.Emri i personit kontaktues dhe telefoni	[4]
5.Emri i marrësit	[5]
6. Numri ID i marrësit	[6]
7.Adresa e marrësit	[7]
8. Emri i personit kontaktues dhe telefoni	[8]
9.Shuma e kontributeve bamirëse të dhuruara	[9]
10. Data e donacionit	[10]

**Me këtë deklaroj se të dhënat e deklaruara më lartë janë të vërteta dhe të sakta. Marrësi nuk ka ndonjë konflikt të interesit direkt apo indirekt me donatorin.**

Emri dhe nënshkrimi i personit të caktuar  
(\_\_\_\_\_)

dd/mm/vvvv  
\_/\_/\_

## Neni 18

### Tabelat e tatimit në paga të mbajtur në burim

Neni 17.2 i Rregullores parasheh që punëdhënësit kryesor duhet të zbresin tatimin e mbajtur në burim nga pagat e të punësuarve sipas Tabelave të Tatimit në Paga të Mbajtur në Burim. Këto tabela janë bashkëngjitur këtij Udhëzimi Administrativ si Aneksi 1.

## Neni 19

### Dorëzimi i Pasqyrës së Mbajtjes në Burim dhe Pagesës së Tatimit në Paga

Neni 17.4 i Rregullores parasheh që punëdhësit do të dorëzojnë një pasqyrë të tatimit të mbajtur në burim dhe të derdhen shumë korrekte të tatimit të mbajtur në burim në një bankë të licencuar nga BPK dhe të aprovuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ secili punëdhënës do të dorëzojë një Pasqyrë të Mbajtjes në Burim dhe Pagesës së Tatimit në Paga dhe të derdhë shumë të tërësishme të tatimit të mbajtur në paga në një bankë të autorizuar më ose deri në ditën e 15-të të muajit që pason muajin në të cilin pagat janë paguar ose akruar.

Një transfer bankar mund të bëhet në vend të një pagesë me para të gatshme. Urdhëri për transferin e parave duhet t'i bashkëngjitet Pasqyrës së Mbajtjes në Burim dhe Pagesës së Tatimit në Paga në kohën e dorëzimit.

Punëdhënësit të cilët paguajnë paga më shpesh se një herë në muaj dhe të cilët dëshirojnë të mbajnë në burim dhe paguajnë tatimin më shpesh se një herë në muaj munden ta bëjnë atë duke dorëzuar Pasqyrën e Mbajtjes në Burim dhe Pagesës së Tatimit në Paga dhe duke treguar se a është korrekta apo pagesë shtesë për atë muaj.

Pasqyra e Mbajtjes në Burim dhe Pagesës së Tatimit në Paga duhet të dorëzohet në një nga bankat e autorizuar në Kosovë dhe tatimi duhet të derdhet tërësisht në të njëjtën kohë. Pasqyra është e dizajnuar në tri kopje. Kopja e parë dhe e dytë duhet të mbahen nga banka dhe kopja e tretë duhet t'i jepet punëdhënësit. Format i Pasqyrës së Mbajtjes në Burim dhe Pagesës së Tatimit në Paga është me sa vijon:



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO  
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS  
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



## PASQYRA E MBAJTJES NË BURIM DHE PAGIMIT TË TATIMIT NË PAGA

[1] Periudha e Dorëzimit: [11] [2] Nr. Serial: [2]IWM

[3] Nr. Rregjistrimit të Punëdhënësit: [3]

[4] Emri i Punëdhënësit [4]

[5] Adresa e Punëdhënësit [5]  
(vetem nese ka ndryshuar)

[6] Emri i Personit të Kontaktit [6] Telefon [6]

[6] Emri i Personit të Kontaktit [6] Telefon [6]

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzoni për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit.

Shtesë  Korrigjim  Vetëm pagesë

[8] Pagat Bruto për Muajin: [8]

[9] Tatimi i mbajtur/i paguar për muajin: [9]

Të dhëna mbi numrin e të punësuarve për kategori të ardhurash:

Numri total i të punësuarve për muajin	Numri i të punësuarve që fitojnë paga deri 80 Euro/muaj	Numri i të punësuarve që fitojnë paga nga 80.01 - 250 Euro/muaj	Numri i të punësuarve që fitojnë paga nga 250.01-450 Euro/muaj	Numri i të punësuarve që fitojnë paga mbi 450 Euro/muaj
[10]	[11]	[12]	[13]	[14]

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe Vula

dd/mm/vv

(\_\_\_\_\_)

\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Nënshkrimi dhe vula  Data ____/____/____	Numri i llogarisë: <b>1000420070000373.</b>	[17] Shuma e tatimit të paguar
--	---	--------------------------------

Neni 20

Dorëzimi i Pasqyrës Vjetore të Barazimit të Tatimit në Paga

Neni 17.5 i Rregullores parasheh që punëdhënësit duhet të dorëzojnë një pasqyrë vjetore të barazimit të tatimit në paga në Administratën Tatimore të Kosovës deri më 31 Janar të vitit të pason periudhën tatimore. Pasqyra vjetore e barazimit të tatimit është një përmbledhje e Pasqyrave Mujore të Mbajtjes në Burim dhe Pagimit të Tatimit në Paga. Format i është me sa vijon:



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO  
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS  
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



**PASQYRA VJETORE E BARAZIMIT TË TATIMIT NË PAGA**

[1] Periudha e Dorëzimit:  [2] Nr. Serial:

[3] Nr. Rregjistrimit të Punëdhënësit:

[4] Emri i Punëdhënësit

[5] Adresa e Punëdhënësit   
(vetem nese ka ndryshuar)

Telefon

[6] Emri i Personit të Kontaktit  Telefon

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzon për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit.

Shtesë  Korrigjim  Vetëm pagesë

[8] Pagat Bruto për periudhën tatimore:

[9] Tatimi i mbajtur për periudhën tatimore:

[10] Tatimi i paguar për periudhën tatimore:

Shënim: Çdo punëdhënës duhet t'i bashkangjesë këtij formulari një kopje të Rregjistrimit Vjetor të Listë-Pagesave.

**Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.**

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe Vula

(\_\_\_\_\_)

dd/mm/vv

\_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

Në faqen e prapme të Pasqyrës Vjetore të Barazimit të Tatimit në Paga do te jetë e printuar një kopje e list-pagesës përmbledhëse vjetore e cila duhet plotësuar dhe dorëzuar në të njëjtën kohë me Pasqyrën.

Neni 21

Çertifikata e Mbajtjes në Burim të Tatimit në Paga

Neni 17.6 i Rregullores parasheh që punëdhësi të sigurojë, deri më 1 Mars të vitit që pason periudhën tatimore, një çertifikatë të mbajtjes në burim për secilin të punësuar nga të cilët tatimi në paga është mbajtur në burim gjatë periudhës tatimore. Çertifikata poashtu do të përmbajë të dhënat për Kontributet Pensionale. Format i Çertifikatës për Mbajtje në Burim është si vijon:

<b>Çertifikatë e Kontributit Pensional dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit në Paga</b>				
[1]Emri i Punëdhënësit	<input style="width: 90%;" type="text"/>			
[2]Nr. Rregj. Punëdhënësit	<input style="width: 40%;" type="text"/>	<input style="width: 55%;" type="text"/>		
[3]Adresa e Punëdhënësit	<input style="width: 60%;" type="text"/>		[4]Tel:	<input style="width: 20%;" type="text"/>
[5]Emri i Pronarit/Menaxheri	<input style="width: 60%;" type="text"/>		[6]Tel:	<input style="width: 20%;" type="text"/>
<b>Kjo Çertifikatë e kontributeve pensionale dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit në të Ardhura Personale i lëshohet të punësuarit në vijim:</b>				
[7]Emri i të Punësuarit	<input style="width: 90%;" type="text"/>			
[8] NP i UNMIK-ut/ Numri Individual i Tatimpagues...	<input style="width: 90%;" type="text"/>			
[9]Adresa e të Punësuarit	<input style="width: 80%;" type="text"/>			[10]Tel: <input style="width: 15%;" type="text"/>
Unë deklaroj se të dhënat e paraqitura mëposhtë janë të vërteta:				
<b>Periudha tatimore</b>	<b>Të ardhurat bruto</b>	<b>Kontributi pensional i Punëdhënësit(*)</b>	<b>Kontributi pensional i të Punësuarit</b>	<b>Tatimi i Mbajtur në Burim</b>
<input style="width: 100%;" type="text"/>	<input style="width: 100%;" type="text"/>	<input style="width: 100%;" type="text"/>	<input style="width: 100%;" type="text"/>	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Emri, Nënshkrimi dhe Vula e Punëdhënësit/Personit të Caktuar (_____)				dd/mm/vv ____/____/____
(*) Kontributi Pensional i punëdhënësit nuk është as i zbritshëm nga të Ardhurat Bruto e as nuk përfshihet në të Ardhurat Bruto të të punësuarit				

## Neni 22

### Dorëzimi i Pasqyrës Mujore dhe Pagimit të Tatimit të Mbajtur në Burim në Interes, Divident, Qira dhe Fitoret në Lotari

